


Analizë Politikash - Nr. 02/2011

Marrëveshja e Kosovës me Serbinë mbi Vulat Doganore:

Sfidat dhe e Ardhmja?



Grupi për Studime
Juridike dhe Politike



Për GSJP

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është think-tank me seli në Kosovë. Grupi është njëri ndër institucionet më të shquara që ofron hulumtime akademike dhe hulumtime të politikave në Evropën Jug-Lindore. Grupi për Studime Juridike dhe Politike është kryesisht i drejtuar në hulumtimet në fushën politike, juridike dhe ekonomike, megjithatë vëmendje të veçantë i kushton fenomenit të demokratizimit në vendet post-komuniste. Grupi mëton të përdor hulumtimet e politikave dhe zgjidhjet e ofruara për të avancuar procesin e demokratizimit dhe të integritimit Evropian në Kosovë.

Pika përmbledhëse:

- A. Marrëveshja mbi Vulat Doganore në mes Kosovës dhe Serbisë paraqet hapin themelor i cili do të mund të shfrytëzohej për vendosjen e kontrollit efektiv mbi kufirin e Kosovës me Serbinë;
- B. Zbatimi i Marrëveshjes mbi Vulat Doganore është përcaktor i trendeve dhe mundësive të ri-balancimit të raporteve të Qeverisë së Kosovës, në njërën anë, dhe strukturave paralele dhe Qeverisë së Serbisë në veriun e Kosovës, në anën tjetër;
- C. Bashkërendimi me KFOR-in dhe EULEX-in për zbatimin e Marrëveshjes mbi Vulat Doganore është veprim racional, dhe mbetet rruga më e sigurt për të kthyer rendin dhe ligjin në veriun e Kosovës;
- D. Zbatimi sipas Plani të Qeverisë së Kosovës i Marrëveshjes mbi Vulat Doganore, në njërën anë, dhe mobilizimi i serbëve në veriun e Kosovës nëpërmjet direktivave të Qeverisë së Serbisë për barrikadimin e territorit, kërkohet të paraqitet si argument nga Serbia për negociimin e paradigmës 'Ahtisari Plus' në veriun e Kosovës. Thënë ndryshe, Serbia kërkon vënien në jetë të dy zgjidhjeve asimetrike për të njëjtin komunitet etnik që jeton në Kosovë;
- E. Tendencia që zbatimi ose moszbatimi i Marrëveshjes për Vulat Doganore të shfrytëzohet për nevoja të legjitimitetit të brendshëm të qeverive të dy shteteve është evident;
- F. Çështja e lëvizjes së lirë të mallrave, nëpërmjet marrëveshjes në fjalë, është standard themelor në procesin e integritetit evropian për të dyja vendet;
- G. Indikatorët themelor të tregtisë në mes Kosovës dhe Serbisë, edhe në kohën e krizave më të fuqishme ndëretnike pas vitit 1999, tregojnë që konsumi i mallrave serbe apo importi i tyre në Kosovë nuk ka shënuar rënie: prandaj, probabiliteti që mallrat serbe të kenë humbur tregun e Kosovës gjatë kësaj periudhe është shumë i ulët, mbi bazën e të dhënave statistikore dhe trendeve të tyre;
- H. Në fund, Marrëveshja për Vulat Doganore duhet të shihet si një formë e pranimit të shtetësisë së Kosovës nga Serbia, meqë regjimet doganore janë attribute vetëm të shteteve të pavarura.

Analizë Politikash Nr. 02/2011

Shtatorë 2011



Ky projekt është financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (Fondacioni Soros), Prishtinë, Kosovë. Mendimet e shprehura në këtë publikim jo-domosdo paraqesin mendimet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOROS).

Grupi për Studime Juridike dhe Politike & Lëvizja Evropiane në Kosovë

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, 2011.

Opinionet e shprehura në këtë publikim jo-domosdo paraqesin mendimet e GSJP. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të kopjohet ose përhapet me asnjë formë ose mjet pa lejen paraprake të Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Ky publikim (në formë të shtypur) mund të porositet në këmbim të një tarife. Për kërkesat e tilla, ju lutem kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Informacionet kontaktuese mund ti gjendet në faqen elektronike të Grupit. Nëse ju dëshironi të vëni në përdorim këtë publikim, ju lutem kontaktoni GSJP për leje paraprake.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. 'Rexhep Luci' 10/5-1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Web-site: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 227 944

I. HYRJE

Dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë e pason Opinionin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), dhe buron konkretisht nga Rezoluta 64/298 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Rezoluta në fjalë e mirëpret Opinionin e GjND-së për Ligjshmërinë e Pavarësisë së Kosovës, dhe kërkon nga Bashkimi Evropian që të lehtësoj një dialog në mes Kosovës dhe Serbisë.¹ Si rezultat i kësaj, nën kërkesën e BE-së, Kosova dhe Serbia emëruan negociatorët e tyre për të vazhduar më tutje me dialogun në mes tyre. Takimi i parë në mes negociatorëve të Kosovës dhe Serbisë – përkatësisht znj. Edita Tahiri, zv. Kryeministre e Republikës së Kosovës dhe z. Borislav Stefanovic, shefi i Ekipit Negociator në dialogun me Kosovës – u mbajt më 8-9 Mars 2011, ku të dyja palët shprehën përkushtimin e tyre për të vazhduar dialogun nën tutelën e Bashkimit Evropian.² Çështjet e para që u bënë objekt i dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë ishin çështja e librave të regjistrave civil, çështja e të dhënave të regjistrave kadastral, si dhe çështjet që u lidhen me tregtinë regjionale në kuptimin e lirisë së lëvizjes së mallrave.³

Marrëveshjet e para në mes palëve u shpallën me 2 Korrik 2011, të cilat shprehnin dakordimin e të dyja palëve mbi tre çështje: a) një marrëveshje mbi regjistrat civil, b) një marrëveshje mbi lirinë e lëvizjes së qytetarëve dhe automjeteve, dhe c) një marrëveshje mbi pranimin e diplomave universitare dhe institucioneve të niveleve tjera arsimore të qytetarëve nga të dyja shtetet.⁴ Në të njëjtën datë, Robert Kuper – Përfaqësuesi i BE-së për Dialogun Kosovë Serbi – shprehu që gjatë takimit të korrikut, çështjet e telekomunikimit, regjistrave

kadastral, vulave doganore dhe çështjet që lidhen me energjinë janë afër koncesusit të palëve.⁵ Në përgjithësi, z. Kuper parashihte që takimi i ardhshëm në mes negociatorëve të dy palëve të jetë me 20 korrik 2011.

Më 19 korrik 2011, zyra e Robert Kuper-it informon publikun që takimi i përcaktuar që të mbahej më 20 korrik 2011 shtyhet për në shtator të të njëjtit vit.⁶ Kjo shtyrje erdhi si rezultat i refuzimit të palës serbe, të përfaqësuar nga shefi i Ekipit Negociator të Serbisë, për të marrë pjesë në takimin ku do të diskutoheshin vulat doganore dhe lëvizja e lirë e mallrave në mes dy vendeve. Çështja e Vulave Doganore ishte pika më kryesore e përparësisë për Qeverinë e Kosovës, meqë Serbia vazhdonte të refuzonte importet nga Kosova me arsyetimin që mallrat që vinin nga Kosova vuloseshin me vullë të Republikës së Kosovës.⁷ Në të njëjtën kohë, Serbia vazhdonte eksportin e pakufizuar në Kosovë, përmes dy pikave doganore – pikat 1 dhe 31 – që realisht nuk ishin nën kontrollin efektiv të Qeverisë së Kosovës. Prandaj, në ditën e njëjtë kur Ekipi Negociator Serb vendosi ta bojkotoj takimin për vulat doganore – pra në datën 19 korrik 2011 – i njëjti u konsiderua i njëanshëm nga Qeveria e Kosovës, dhe e njëjta vendosi që të zbatoj masat e reciprocitetit ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës që importoheshin në Kosovë. Vendimi mbi masat e reciprocitetit i Qeverisë së Kosovës detyronte aplikim të tatimit doganor 10% për mallrat që importoheshin nga Bosnja e Hercegovina, përderisa vendimi në fjalë vendoste masën reciproke ndaj Serbisë, duke mos ia njohur vulat doganore.⁸ Praktikisht, vendimi mbi aplikimin e masave të reciprocitetit në tregti ndaj këtyre dy shteteve nënkuptonte ndalim absolut të tregtisë së Serbisë me Kosovën.

¹ Shih: Resolution adopted by the General Assembly, 'Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of independence of Kosovo is in accordance with international law', 13 October 2010, UN Doc. A/RES/64/298.

² European Union, Press Statement: 'EU facilitated dialogue: A positive start Brussels, 8-9 March 2011 Brussels.' 7566/11, Brussels, 9 March 2011.

³ European Union, Press Statement: 'EU facilitated dialogue: A positive start Brussels, 8-9 March 2011 Brussels'. 7566/11, Brussels, 9 March 2011.

⁴ European Union, Press Statement: 'EU facilitated dialogue: three agreements Brussels, 2 July 2011'. 12410/11, Brussels, 2 September 2011.

⁵ Shih European Union, Press Statement: 'EU facilitated dialogue: three agreements Brussels, 2 July 2011'. 12410/11, Brussels, 2 September 2011.

⁶ Shih European Union, Press Statement: 'EU facilitated dialogue: next round of talks postponed'. 13119/11 Brussels, 19 July 2011.

⁷ Po i njëjti problem u diskutua edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2009. Shih: Staff Working Document: 'Kosovo under UNSCR1244/99 2009 Progress Report'. Commission of the European Communities, SEC(2009) 1340, Brussels.

⁸ Shih: Vendim i Ministres së Tregtisë dhe Industrisë për Parimin e Reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare, Nr. 5422, date 20 Korrik 2011.

Meqë Vendimi i Qeverisë së Kosovës për aplikimin e reciprocitetit në tregtinë me Serbinë nuk mund të zbatohet efektivisht në pikat kryesore doganore që lidhin Kosovën dhe Serbinë – pikat doganore I dhe 31 – Qeveria e Kosovës vendosi që të dërgoj Njësinë Speciale ROSU të Policisë së Republikës së Kosovës për t'i marrë nën kontroll efektiv këto dy pika kufitare me Serbinë. Pikat I dhe 31, formalisht kontrolloheshin nga Policia e Republikës së Kosovës me policë të komunitetit serb, megjithatë faktikisht të njëjtët nuk kishin kontroll në këto dy pika. Dërgimi i Njësisë ROSU në këto dy pika, që në fakt ishte marrje e kontrollit faktik të këtyre dy pikave nga Qeveria e Kosovës, rezultoi me ngritjen e barrikadave nga serbët lokal që jetojnë në territorin e veriut të Kosovës. Bashkë me vendosjen e barrikadave, një grup serbësh dogji pikën doganore I – Pika Doganore Jarinjë – dhe kjo solli reagimin e KFOR-it, i cili morri nën kontroll ushtarak të dy pikat doganore.⁹

Në të njëjtën kohë, KFOR-i ofroj një marrëveshje për Qeverinë e Kosovës dhe Qeverinë e Serbisë, dhe Qeveria e Kosovës e refuzoj atë më 3 korrik 2011. Me këtë rast, Qeveria e Kosovës paraqiti 10 kushtet e saj për KFOR-in, dhe i fundit u pajtua me to. Ndër këto 10 kushte përfshihej edhe heqja e barrikadave nga rrugët që ishin vendosur nga serbët lokal, mbajtja e *status quos* në pikat doganore I dhe 31, që KFOR-i të merrte kontrollin efektiv të tyre nën një regjim ushtarak, dhe që të dy portat të jenë të mbyllura nën statusin e zonave ushtarake. Pikat e Qeverisë së Kosovës gjithashtu ndalonin qarkullimin e mallrave komerciale në pikat I dhe 31, dhe lejonin kalimin vetëm të ndihmave humanitare me makina deri në 3.5 ton dhe të mallrave të dedikuara për Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë. të njëjtat kushte përcaktonin edhe detyrimin e KFOR-it që të kontrollonte për armatim cdo makinë që kalonte në pikat I dhe 31.¹⁰

⁹ Shih: KFOR, Public Affairs Office, Press release: 'GATE I at Jarinjë is closed', available at:

<http://www.nato.int/kfor/docu/pr/2011/07/20110728a-eng.pdf>.

¹⁰ Gazeta Zeri, 'Zyrtare, arrihet marrëveshja me KFOR', 05-08-2011, e aksesueshme në, <http://www.zeri.info/artikulli/11/1/31464/zyrtare-arrihet-marreveshja-me-kfor/>.

Ndalimi i eksportimit të mallrave të Serbisë në Kosovë, e detyroi Serbinë që t'i kthehej tryezës së dialogut me Kosovën në lidhje me vulat doganore. Në takimin e gjashtë me radhë, të mbajtur në mes të dy palëve, nën facilitimin e Bashkimit Evropian, dhe këtë herë edhe nën praninë e Filip Reeker, përfaqësues i Shteteve të Bashkuara në Dialogun Kosovë-Serbi, u arrit marrëveshja në mes Kosovës dhe Serbisë mbi vulat doganore dhe heqjen e embargove tregtare në mes dy vendeve.¹¹ Në njoftimin zyrtar të zyrës së Robert Kuper shënohet që Marrëveshja mbi Vulat Doganore përfshin pajtimin e të dyja palëve për pranimin e vulave të Kosovës me shenjën 'Doganat e Kosovës'.¹² Detaje tjera nuk janë dhënë ende nga zyra në fjalë, përderisa Qeveria e Kosovës vazhdon të jetë absolutisht e mbyllur lidhur me substancën e kësaj marrëveshjeje.

Në Kosovë, Marrëveshja mbi Vulat Doganore u konsiderua nga Qeveria si pranim i Kosovës shtet i pavarur nga Serbia. Në anën tjetër, partitë opozitare – e në veçanti partia Vetëvendosje – e kundërshtoj fuqishëm marrëveshjen, duke e quajtur atë si hap që pranon sprapsjen e Qeverisë së Kosovës nga veriu i Kosovës, meqë sipas saj, masa e reciprocitetit e vendosur me Serbinë realisht nuk u zbatuar asnjëherë. Sipas Vetëvendosjes, marrëveshja në fjalë po vulos kthim pas të Qeverisë së Kosovës në gjendjen para 25 korrikut.¹³

Ne Serbi, Marrëveshja mbi Vulat Doganore u konsiderua nga Qeveria si një zgjidhje neutrale ndaj statusit të Kosovës, përderisa shefi i Ekipit Negociator, Borislav Stefanovic, arsyetoj që

¹¹ Shih: Deklaratë për Shtyp, 'Dialogu i Facilituar nga BE-ja: Marrëveshja mbi Vulat Doganore dhe Kadastrën'. 13772/11, Bruksel, 2 shtator 2001. Doc. Nr. PRESSE 294, Këshilli i Bashkimit Evropian, e aksesueshme në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/124501.pdf.

¹² Shih: Deklaratë për Shtyp, 'Dialogu i Facilituar nga BE-ja: Marrëveshja mbi Vulat Doganore dhe Kadastrën'. 13772/11, Bruksel, 2 shtator 2001. Doc. Nr. PRESSE 294, Këshilli i Bashkimit Evropian, e aksesueshme në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/124501.pdf.

¹³ Levizja Vetëvendosje, 'Edita Tahiri vulosi zbrapsjen e Hashim Thaçit nga veriu i Kosovës', 04 SHTATOR 2011, e aksesueshme në: <http://www.vetevendosje.org/?cid=1,2,3223>

marrëveshja në fjalë nuk përmbantribute shtetësie për Kosovën.¹⁴ Në anën tjetër, marrëveshja u kundërshtua fuqishëm edhe nga opozita në Serbi. Slobodan Samardžić, Nënkrjetar i Partisë Demokratike të Serbisë, shprehu qëndrimin që konsensusi i Qeverisë së Serbisë për marrëveshjen në fjalë është realisht një hap i heqjes dorë nga Kosova, për qëllime të kompensimit jo-të-duhur me marrjen e kandidaturës për në BE.¹⁵ I njëjti argumentoj që marrëveshja shpreh, sipas tij, që Doganat e Kosovës dhe Policia e Kosovës me policë shqiptar do vendosin kufirin në atë çfarë Serbia e quan 'kufi administrativ'.¹⁶ Marrëveshja gjithashtu u kundërshtua fuqishëm edhe nga strukturat e Serbisë në veriun e Kosovës. Radenko Nedeljković, Përfaqësues të ashtuquajturit 'Qark i Mitrovicës', konsideroj që marrëveshja në fjalë nuk do të pranohet nga serbët e veriut të Kosovës, meqë shkonte në kundërshtim me interesat e tyre. I njëjti shprehu që serbët e veriut do të shfrytëzojnë të gjitha mjetet 'politike dhe demokratike' për të mos lejuar zbatimin e saj, meqë marrëveshja do të nënkuptonte sipas tij njohjen e Kosovës.¹⁷ I njëjti qëndrim u mbajt edhe nga Kryetari i Komunës Paralele të Leposaviqit, Branko Ninic, përderisa Kryetari i Komunës Paralele të Zubin Potokut, Sllavisa Ristic, akuzoi Qeverinë e Serbisë për tradhti ndaj serbëve të Kosovës me këtë marrëveshje.¹⁸ Në të njëjtën linjë, Krstimir Pantic, Kryetar i Komunës Paralele të Mitrovicës, e kundërshtoj marrëveshjen, duke

arsyetuar që nëse Kosova është pjesë e Serbisë, atëherë nuk mund të ketë regjim doganor në mes të dy vendeve.¹⁹ Në përgjithësi, qëndrimi i përfaqësuesve paralelë serb në veriun e Kosovës ishte në linjë me argumentin që pranimi i vulave doganore të Kosovës nga ana e Serbisë është hap që shënon njohjen e Kosovës nga kjo e fundit, meqë praktikisht regjimet doganore vendosen dhe pranohen vetëm në mes të shteteve të pavarura.

Bashkimi Evropian vazhdoj ta quaj marrëveshjen thjesht të rëndësishme për qytetarët e zakonshëm, duke arsyetuar që mundësi i lëvizjes së lirë të mallrave në mes dy vendeve do e bëj regjionin të duket më 'evropian'.²⁰ Qëndrimi i BE-së, prandaj, është i rezervuar ndaj efekteve politike që do ketë marrëveshja, duke tentuar që të mos zbulojnë efektet që do lindin në proceset e mëvonshme. I të njëjtës linjë ishte edhe Presidenti i Këshillit Evropian, Herman Van Rompuy, i cili e quajti marrëveshjen si të rëndësishme për përmirësimin e marrëdhënieve regjionale, meqenëse kjo mundëson lëvizjen e lirë të mallrave sipas standardeve evropiane.²¹

II. Sfidat dhe e Ardhmja e Zbatimit të Marrëveshjes

Zbatimi i Marrëveshjes lidhet ngushtësisht me vënien nën kontroll të pikave doganore I dhe 3I nga ana e Qeverisë së Kosovës. Në lidhje me këtë, Qeveria e Kosovës publikisht ka deklaruar që me datën 16 shtator 2011 do filloj ta zbatoj Marrëveshjen mbi Vulat Doganore me anë të doganierëve të Republikës së Kosovës. Kjo

¹⁴ Shih: B 92, 'Team chief: Kosovo stamp has no statehood attributes', 3.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76221

¹⁵ Shih: B 92 'Opposition DSS accuses govt. of "capitulation"', 3.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76216

¹⁶ Shih: B 92 'Opposition DSS accuses govt. of "capitulation"', 3.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76216

¹⁷ Shih: B 92, 'K. Serbs: Customs stamp agreement unacceptable', 3.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76218; dhe Gazeta Express, 'Serbët e veriut kundër Stefanovicit', 05 Shtator 2011, e aksesueshme në: <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,13,62171>.

¹⁸ Shih: B 92, 'K. Serbs: Customs stamp agreement unacceptable', 3.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76218.

¹⁹ Shih: B 92, 'K. Serbs: Customs stamp agreement unacceptable', 3.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76218.

²⁰ Shih, B 92, 'Agreement on customs stamps "important to ordinary citizens"', 03.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76215.

²¹ Shih: European Council, The President, 'Statement by Herman Van Rompuy, President of the European Council following his meeting with Atifete Jahjaga President of Kosovo'. EUCO 66/11, Brussels, 6 September 2011.

nënkupton që pikat I dhe 3I të merren nën kontroll nga regjimi doganor i Doganave të Republikës së Kosovës dhe Policisë së Republikës së Kosovës, për të zbatuar legjislacionin doganor mbi mallrat që hyjnë dhe dalin nga Kosova në këto dy pika. Qeveria e Kosovës shprehet që kontrolli efektiv mbi këto dy pika doganore do bëhet sipas një marrëveshje me KFOR-in dhe EULEX-in.²² Vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'i vendosur dy pikat doganore në kufi me Serbinë nën kontrollin efektiv të saj po pritet me kundërshtime të ashpra nga ana e Qeverisë së Serbisë. I njëjti qëndrim po jepet edhe nga serbët që jetojnë në veri të Kosovës, dhe në veçanti strukturat paralele të vendosura nga Serbia atje.

Zëvendës-kryeministri serb, Ivica Dačić, duke shprehur qëndrimin e qeverisë së tij, arsyeton që Marrëveshja mbi Vulat Doganore zgjidh vetëm një problem të vogël, përderisa, sipas tij, tendenca për ta shndërruar ndarjen administrative me Kosovën në ndarje shtetërore është pjesa e problemit të madh.²³ Për më tepër, zyrtarët më të lartë të Serbisë po paralajmërojnë që masat e Kosovës për vënie nën kontroll të pikave I dhe 3I do të kundërshtohen në mënyrë politike dhe diplomatike, megjithatë, zëvendës-kryeministri serb Ivica Dačić ka paralajmëruar që hapat e njëanshëm të Kosovës do të shprijnë edhe në pasojat serioze dhe konflikte të mëdha në regjion. I njëjti gjithashtu ka paralajmëruar që Serbia nuk mund të bëjë çdo gjë për rrugën e saj integruese në BE. Qëndrimi zyrtar i Serbisë, prandaj, po bëhet gjithnjë e më serioz sa i përket mundësisë së ndonjë konflikti tjetër në regjion, duke dhënë paralajmërimet që nuk do heq dorë nga kontrolli i veriut të Kosovës.²⁴

Në anën tjetër, Serbia i ka mobilizuar serbët në veriun e Kosovës që të ngritin barrikada nëse Qeveria e Kosovës vë nën kontroll pikat doganore I dhe 3I. Tendanca e Beogradit për t'i mobilizuar serbët në veri të Kosovës në rastin e tillë është tregues që zbatimi i Marrëveshjes mbi Vulat Doganore mund të mbetet problematik, përderisa Qeveria e Kosovës mund të përballet sërish me një kundërshtim të fuqishëm nga banorët lokal në veriun e Kosovës.

Plani i Qeverisë së Kosovës – i konkluduar në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in – përcakton që kontrolli i pikave I dhe 3I të bëhet nga ana e policëve dhe doganierëve të EULEX-it, përderisa ata do të komandohet nga komandantët e Policisë dhe Doganave të Republikës së Kosovës. Praktikiht, ky plan i Qeverisë së Kosovës mundëson që kufiri i Kosovës me Serbinë të kontrollohet efektivisht nga KFOR-i dhe EULEX-i, në aspektin operacional, kurse udhëheqja e tyre të bëhet nga institucionet e Republikës së Kosovës.²⁵ Në të njëjtën kohë, më 12 shtator 2011 EULEX-i ka informuar Qeverinë e Serbisë për qëllimin e rikthimit nën kontroll të pikave doganore I dhe 3I, brenda kuadrit të Marrëveshjes të Arritur me Qeverinë e Kosovës dhe KFOR-in. Praktikiht, megjithëse me trupa ndërkombëtare, Serbia do e humb mundësinë që të kontrollojë këto dy pika që e lidhin atë me territorin e Kosovës dhe me serbët që kalojnë në pikat I dhe 3I. Kjo do të shënoj një lloj shkëputje faktike të autoritetit të Serbisë në kufirin me Kosovën, dhe do të përkthejë edhe në humbje të rolit të saj sa i përket qarkullimit dhe kontrollit të qarkullimit të mallrave dhe njerëzve në këtë kufi. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës mund të fillojë një proces gradual të institucionalizimit të autoritetit të saj në kufirin me Serbinë, gjë e cila praktikiht do të reflektohet edhe në dobësim të strukturave paralele dhe kriminale të Serbisë në veriun e Kosovës. Analizë Politikash

²² Shih: Koha Ditore, 'Kosova në veri, vetëm me udhëheqës të pikave doganore'. 13 Shtator 2011, Nr. 5116.

²³ Shih: B 92, 'Deputy PM: Agreement only solves small part of problem', 03.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=03&nav_id=76220.

²⁴ Shih: B 92, 'Agreements without Belgrade unacceptable', 13.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=13&nav_id=76359; dhe B 92, 'President: Serbia will not accept imposed solution',

13.09.2011, available at: http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=09&dd=13&nav_id=76374.

²⁵ Shih: Koha Ditore, 'Kosova në veri, vetëm me udhëheqës të pikave doganore'. 13 Shtator 2011, Nr. 5116.

Në këtë mënyrë, qëndrimi i Qeverisë së Kosovës për një strategji të përbashkët me KFOR-in dhe EULEX-in sa i përket vënies nën kontroll të pikave doganore dhe kufirit me Serbinë është një veprim racional dhe mënyra më perfide për të vënë nën kontroll kufirin në fjalë. Për më tepër, strukturat kriminale në veri të Kosovës do të jenë shumë herë më të kufizuara për të sulmuar doganierët dhe policët e EULEX-it që do kenë nën kontroll pikat I dhe 31, meqë kjo do të shihet si sulm ndaj vet BE-së. Në përgjithësi, veprimet e Qeverisë së Kosovës sipas një bashkërendimi ndërkombëtar mund të shndërrohen në hapat e parë real të shkëputjes së lidhjes territoriale që ka Serbia me veriun e Kosovës dhe serbët që jetojnë atje, dhe natyrisht kjo do të reflektoj në dobësim të strukturave paralele serbe. Prandaj, bashkëpunimi me KFOR-in dhe EULEX-in – të cilët janë të aftë për ta kontrolluar eskalimin e situatës – është hap racional që duhet ndjekur në vazhdimësi. Për EULEX-in, ky është një hap para sa i përket qëndrimit ndaj sovranitetit të Kosovës dhe paradigmes neutrale ndaj statusit të Kosovës, dhe në këtë mënyrë BE-ja po merr një rol më të qartë përballë vendosjes së rendit dhe ligjit në veri të Kosovës.

III. Marrëveshja: sfidat ekonomike dhe politike?

Zbatimi i Marrëveshjes reflekton shumë pasoja në rrafshin politik dhe atë ekonomik. Argumenti i Qeverisë së Kosovës që zbatimi i Marrëveshjes mbi Vulat Doganore me Serbinë është hap ekonomikisht i favorshëm për Kosovën meqë, sipas tyre, mallrat e Serisë kanë humbur tregun në Kosovë, është pothuajse joracional dhe nuk reflekton trendet që bazohen në tabelën I.




Figura 1²⁶




Figura 2

Mënyra për të matur nëse mallrat serbe në Kosovë e kanë humbur konkurrencën e tyre për shkak të embargos dy-mujore është që të shikojmë bilancin tregtar të Kosovës dhe Serbisë në periudhën 2003-2011. Indikatorin themelor që mund të përcaktoj nëse ky trend ka probabilitet të

²⁶ Të dhënat e paraqitura në figurat 1 dhe 2: Enti i Statistikave të Kosovës, Statistikat Ekonomike, Statistikat e Tregtisë dhe Jashtëme, të aksesueshme në: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/10-statistikat-ekonomike/14-statistikat-e-tregtisë-se-jashtme.

ndryshoj është që të shikohet nëse periudhat e tensioneve etnike në Kosovë – dhe keqësimet e skajshme të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë – janë shprehur edhe në rënie të konsumit të mallrave serbe dhe të importit të tyre në Kosovë. Për këtë, i marrim dy indikator: a) importi i mallrave serbe gjatë vitit 2004, vit në të cilin tensionet etnike të shprehura në ngjarjet e marsit kishin arritur kulmin e tyre, dhe b) periudha e vitit 2008, vit në të cilin Kosova shpalli pavarësinë e saj, dhe kur pozita politike e Serbisë përballë Kosovës ishte më e egër sesa gjatë tërë periudhës post-1999, plus ndalja e eksportit të mallrave të Kosovës në Serbi nga ana e Qeverisë së Serbisë. Nëse merremi me indikatorin e parë, do e shohim që në vitin 2004 eksportet e Serbisë shënuan rritje në raport me vitin 2003 në Kosovë, pavarësisht konfliktit etnik që ndodhi me ngjarjet e marsit 2004. I njëjti trend shprehet edhe në vitin 2008, kur u shpall pavarësia e Kosovës, dhe në dy vitet pasuese, eksporti i Serbisë në Kosovë shënoj rritje të mëtejshme. Prandaj, të dy indikatorët tregojnë që konsumi i produkteve serbe në Kosovë në dy kohë krizash etnike dhe acarim të skajshëm të marrëdhënieve në mes dy vendeve nuk ka rënë, përkundrazi ka pasur trende rritjeje. Në këtë kuptim, probabiliteti që argumenti i Qeverisë së Kosovës që mallrat serbe kanë humbur tregun në Kosovë në këto dy muaj mbetet shume i ulët, dhe sjellja empirike e dëshmuar me tabelën e mësipërme sugjeron që Marrëveshja mbi Vulat Doganore do jetë ekonomikisht e favorshme për Serbinë.

Në aspektin politik, Marrëveshja mbi Vulat Doganore ka disa refleksione. Së pari, pranimi i një regjimi doganor nga ana e Serbisë është një formë e pranimit të shtetësisë së Kosovës. Standard themelor i këtij arsyetimi është që regjimet doganore janë attribute të shteteve sovrane, dhe

qëndrimi i Qeverisë së Serbisë se kjo marrëveshje nuk përmban attribute shtetësie është absolutisht joracional. Në anën tjetër, vendosja e kontrollit mbi pikat doganore në veri të Kosovës është formë e institucionalizimit të kontrollit të kufirit me Serbinë, dhe ndërtimit të një rripi ndarës në mes serbëve në veri të Kosovës dhe Serbisë. Kontrolli efektiv i këtij rripi do të reflektonte në humbjen graduale të kontrollit të Serbisë mbi veriun e Kosovës, dhe deimunizimin e strukturave të armatosura kriminale atje.

Në këtë situatë, Qeveria e Serbisë po shfrytëzon serbët lokal në veri të Kosovës për të ngritur barrkada si mjet për ta bërë veriun e Kosovës pjesë të bisedimeve në mes dy shteteve. Tendenca e tillë e Serbisë mbetet ide e rrezikshme për tërësinë territoriale të Kosovës, dhe mund të shpien në formate të zgjidhjeve të ashtuquajtura 'Ahtisari plus'.

Në fund, çështja e zbatimit të Marrëveshjes mbi Vulat Doganore nuk është thjesht çështje ekonomike apo politike, por edhe çështje partiake për qeveritë e Kosovës dhe Serbisë. Në njërën anë, dalja si humbës nga ky proces i Presidentit të Serbisë Boris Tadic, do ta fuqizonte krahun më nationalist të partive në Serbi, dhe për këtë arsye BE-ja vazhdon të mendoj edhe për shpëtimin e humbjes eventuale të pushtetit të Tadicit si rezultat i pasojave të procesit të Dialogut me Kosovën. Në anën tjetër, Kryeministri i Kosovës po tenton që ta rikonsolidoj pozicionin e tij politik brenda Kosovës, dhe për ta rritur autoritetin e tij politik tek elektorati. Me fjalë tjera, zbatimi ose moszbatimi i Marrëveshjes mbi Vulat Doganore ka tendencë të qartë të përdorimit për nevoja të legjitimitit të brendshëm të qeverive të të dyja shteteve.



Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. 'Rexhep Luci' 10/5
Prishtinë 10 000, Kosovë
Web: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 227 944